



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-107
Prishtinë, më 15 qershor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 15 QERSHOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati,
Nga OSBE: Florijana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 8 qershor 2010,
2. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Nait Hasani për debat për dënimin e krimeve të komunizmit në Kosovë,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit Organizativ për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme lidhur me çështjen "Drejtësi në rastin Kiçina",
4. Shqyrtimi i Programit Kombëtar të Shkencës i Republikës së Kosovës,
5. Njoftimi me shkresën e PDAK-së lidhur me përfaqësimin e deputetit Etem Arifi në Kryesinë e Kuvendit.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 qershor 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 qershor 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Nait Hasani për debat për dënimin e krimeve të komunizmit në Kosovë

Lidhur me kërkesën e cekur më lart, në diskutim morën pjesë: Naim Maloku, Xhavit Haliti, Nexhat Daci, Eqrem Kryeziu dhe Ibrahim Gashi.

Kryesia, pas këtyre diskutimeve, vendosi që kjo pikë të riradhitet për mbledhjen e radhës të Kryesisë, në të cilën do të marrin pjesë edhe kryetarët e grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit Organizativ për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme lidhur me çështjen "Drejtësi në rastin Kiçina"

Kryesia lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Këshilli Organizativ lidhur me çështjen "Drejtësi në rastin Kiçina" nuk është organ i autorizuar për të kërkuar thirrjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Peticioni i Këshilli Organizativ lidhur me çështjen "Drejtësi në rastin Kiçina" i dërgohet për shqyrtim Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

4. Shqyrtimi i Programit Kombëtar të Shkencës i Republikës së Kosovës

Kryesia, lidhur me shqyrtimin e Programit Kombëtar të Shkencës nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport që ta shqyrtojë Programin Kombëtar të Shkencës dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

5. Njoftimi me shkresën e PDAK-së lidhur me përfaqësimin e deputetit Etem Arifi në Kryesinë e Kuvendit

Kryesia, lidhur me shkresën e PDAK-së konstatoi se nuk është objekt shqyrtimi i Kryesisë së Kuvendit.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Joformal të Grave për lejimin e udhëtimit zyrtar në Cetinë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtareve të Grupit Joformal të Grave, në këtë përbërje: Flora Brovina dhe Radmilla Vujoviq, në Cetinë, Mali i Zi, prej 20-22 qershor 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurat në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, i mbulon nikoqiri, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë, nr. 03-V-094.

7. Njoftimi i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryesia u njoftua për ndërrimin e terminit të vizitës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në Bruksel, prej 21-23 qershor 2010.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11: 40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale